



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Integrimin Europian*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 09.11.2020, ora 14:00

**Drejton mbledhjen:**

**Senida Mesi – nënkryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Dëgjesë për projektbuxhetin e vitit 2021 me përfaqësues të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme.

**Marrin pjesë:**

Senida Mesi, Arben Kamami, Musa Ulqini, Taulant Balla, Klodiana Spahiu, Mirela Kumbaro, Nikolin Staka, Fatmir Velaj, Ilir Pendavinji, Kostaq Papa, Vasil Sterjovski, Arlind Çarcani, Edlira Hyseni dhe Ralf Gjoni.

**Mungojnë:**

Rudina Hajdari, Sadri Abazi

**Të ftuar:**

Sokol Dedja – Zëvendësministër për Europën dhe Punët e Jashtme

## HAPET MBLEDHJA

**Senida Mesi** – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen *online* sapo të na japë confirmimin IT-ja.

Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë takimin e radhës në Komisionin e Integritit Europian. Sikurse jeni njoftuar do të diskutojmë projektbuxhetin e vitit 2021. Duke respektuar fushën e përgjegjësisë së komisionit kemi të ftuar në këtë dëgjese nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, zotin Sokol Dedja, zëvendësministër, si dhe i ngarkuar posaçërisht për çështjet e integritit.

Në fillim po bëj apelin, por sekretariati më njofton se prezenca është dhe në këtë mënyrë kuorumi është i pranishëm.

Zonja Hajdari mungon. Siç ju e dini është e sëmurë me COVID. Do të dëshiroja që edhe në emrin tuaj t'i uroj shërim të mbarë dhe kthim sa më shpejtë në aktivitetin e saj politik, por jo vetëm!

Zoti Velaj, është prezent.

Po ashtu, prezentë janë zoti Ulqini, zoti Balla, zonja Spahiu, zoti Staka, zoti Papa, zoti Çarçani, zoti Sterjovski, zonja Jaku që nuk mungon asnjëherë së bashku me zonjën Dralo, si dhe sapo u lidh me ne edhe zoti Kamami.

Fjalën po ia kaloj zotit Dedja.

Më pas, pasi ta dëgjojmë me vëmendjen zotin Dedja, do ta marrin fjalën anëtarët e komisionit për sugjerime, vërejtje apo rekomandime, për ta bërë nëse ka hapësira. Më pas të gjitha sugjerimet, diskutimet apo rekomandimet tuaja së bashku me rekomandimet që do të bëjë zoti Dedja do t'ia propozojmë Komisionit të Ekonomisë dhe Financave si komision përgjegjës për projektbuxhetin.

**Sokol Dedja** – Faleminderit, zonja Mesi!

Të nderuar anëtarë,

Unë do të kem nderin t'ju paraqes projektbuxhetin e vitit 2021 për Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme. Fillimisht në mënyrë të shkurtuar do t'ju flas për realizmin e objektivave që ka kryer ministria jonë gjatë vitit 2020, pavarësisht situatës së pazakontë të krijuar nga pandemia

globale dhe shkurtime të qe i janë bërë projektbuxhetit të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme.

Një ndër objektivat kryesorë ka qenë integrimi europian. Këtu vlen të përmend arrijtjen historike e vendimit të Këshillit të muajit mars për hapjen e negociatave të anëtarësimit për Shqipërinë, por edhe paketa e 6 tetorit e Komisionit Europian me vlerësimin për përmbushjen e kushteve për Konferencën e parë Ndërqeveritare, si dhe paketa e investime e paraqitur nga Komisioni Europian, miratimi i një metodologjie të re të negociatave mbi bazën e së cilës vendet anëtare janë duke diskutuar dokumentin që do të rregullojë negociatat, i cili quhet korniza e negociimit.

Përveç integritit europian, objektiv tjetër gjatë vitit 2020 ka qenë kryesimi me sukses i OSBE-së, ku gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar një numër aktivitetesh si konferenca e nivelit të parë mbi luftën kundër antisemitizmit në rajonin e OSBE-së dhe aktualisht jemi në fazën përmbyllëse të përgatitjeve të takimit të ministrave të jashtëm të OSBE-së, që do të mbahet në Tiranë në periudhën 3-4 dhjetor.

Ka vijuar puna për sigurimin e mbështetjes për një vend të përkohshëm në Këshillin e Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për periudhën 2021-2023. Ojektiv shumë i rëndësishëm ka qenë edhe thellimi i bashkëpunimit rajonal, fuqizimi i marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë brenda rajonit, zhvillimi më tej i diplomacisë ekonomike, i shërbimit konsullor dhe forcimi i lidhjeve dhe përfshirja e diasporës.

Projektbuxheti i ministrisë për vitin 2021 është pjesë e hartimit të programit buxhetor afatmesëm 2021-2023. Hartimi i projektbuxhetit është kryer në funksion të aktivitetit diplomatik dhe konsullor të ministrisë, përfshirë këtu misionet diplomatike, postet konsullore jashtë vendit dhe ka në themel objektivat e përcaktuara në programin e qeverisë në planin kombëtar të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Bashkimit Europian dhe planin kombëtar për integrimin europian.

Për vitin 2021 projektbuxheti i ministrisë mundëson vazhdimin normal të përfaqësimit të Shqipërisë në shtetet ku jemi akredituar, si dhe zbatimin e strategjive, politikave dhe objektivave të shërbimit të jashtëm.

Për sa më sipër, orientuar nga prioritetet e politikës së jashtme, projektbuxheti i vitit 2021 mundëson kapacitetet e domosdoshme të mbështetjes financiare për realizimin e objektivave të këtij viti. Ojektiv parësor është fillimi dhe përparimi i procesit të negociatave për anëtarësim në

Bashkimin European, e cila do të kërkojë zhvillimin e kapaciteteve profesionale të stafit të ministrisë dhe të përfaqësive diplomatike për procesin e negociatave.

Në fushat e tjera do të vijojë komunikimi intensiv me vendet anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të siguruar mbështetjen e kandidaturës sonë për një vend jo të përhershëm në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, si dhe përgatitja e strukturave të ministrisë dhe të misionit në Nju Jork me qëllim realizimin e një përfaqësimi sa më dinjitoz në Këshillin e Sigurimit. Do të vijojë forcimi i marrëdhënieve me vendet e rajonit në bashkëpunimin rajonal, përfshirë konsolidimin e marrëdhënieve me Kosovën përmes takimeve të përbashkëta të qeverive, zbatimit të marrëveshjeve të përbashkëta, angazhimit për njohje të mëtejshme ndërkombëtare. Me vendet e tjera do të zhvillohen me prioritet marrëdhëniet me vendet që kemi partneritet strategjik, vendet mike dhe aleate. Përfaqësimi dhe pjesëmarrja aktive në organizatat ndërkombëtare dhe rajonale do të jetë, gjithashtu, një objektivi i vitit 2021, forcimi dhe rritja e rolit të diplomacisë publike, ekonomike dhe diasporës në shërbim të interesave ekonomike të Shqipërisë, promovimi i potencialeve për investime, tregtinë dhe bashkëpunimin ekonomik, tregtar dhe kulturor me partnerët tanë ndërkombëtarë.

Një objektivi tjetër i këtij viti është realizimi i një shërbimi konsullor i mbështetur në profesionalizëm, eficiencë, transparencë dhe përgjegjshmëri, përmes digjitalizimit të shërbimeve konsullore, por edhe forcimit të përfaqësive tona konsullore.

Sa i përket në mënyrë të veçantë procesit të integritimit european, i cili është edhe interesi kryesor i këtij komisioni, programi buxhetor dhe mbështetja institucionale për procesin e integritimit synon mbështetjen e procesit të negociatave të anëtarësimit me Bashkimin European, pra, siç edhe jua thashë fillimin dhe avancimin e negociatave, si dhe demonstrimin përpara shteteve anëtare të aftësisë së Shqipërisë për të plotësuar kriteret e anëtarësimit.

Objektivi i këtij programi buxhetor dhe mbështetja institucionale për procesin e integritimit është, gjithashtu, në përputhje me programin e qeverisë dhe me strategjitë përkatëse kombëtare. Buxheti që është planifikuar të akordohet për vitin 2021 do t'i shërbejë Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme për realizimin e këtyre prioritetëve:

Së pari, zhvillimi i Konferencës së parë Ndërqeveritare për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin European; garantimi i zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit midis Shqipërisë dhe Bashkimit European; forcimi i kapaciteteve institucionale në funksion të procesit të negociatave të anëtarësimit dhe të menaxhimit të asistencës financiare të Bashkimit European;

mirëmenaxhimi i asistencës financiare si përmes procesit të programimit ashtu edhe nëpërmjet procesit të monitorimit të zbatimit të saj.

Ndër aktivitetet që do të realizohen për arritjen e këtyre objektivave është koordinimi i takimeve të institucioneve të përbashkëta Bashkimi European-Shqipëri, i ngritur në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit; koordinimi dhe vlerësimi i procesit të përafrimit të legjislacionit tonë me legjislacionin e Bashkimit European, përfshirë këtu hartimin dhe monitorimin e planit kombëtar për integrimin europian dhe vlerësimi i përputhshmërisë së akteve shqiptare me legjislacionin europian që zhvillohet nga kjo ministri; finalizimi i përgatitjeve për takimet bilaterale në kuadër të procesit *Screening*, përgatitje që kanë filluar dhe kanë avancuar ndjeshëm; monitorimi i plotësimit të rekomandimeve të Këshillit të Bashkimit të European për zhvillimin e Konferencës së parë Ndërqeveritare; programi i fondeve IPA për procesin e anëtarësimit, sipas prioriteteve strategjike dypalëshe të Shqipërisë dhe të Bashkimit European dhe monitorimi i zbatimit të projekteve dhe programeve të asistencës së Bashkimit European.

Menaxhimi i procesit të integritit europian dhe bashkërendimi e tij nuk është politikë e re, pasi ka vite që pasqyrohet në buxhetin e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme dhe nuk është prekur as nga një shkurtim i vogël që ka buxheti i ministrisë sonë për këtë vit.

Nuk po hyj në hollësitë e buxhetit, të cilat u janë paraqitur me shkrim dhe jam i gatshëm për t'iu përgjigjur çdo pyetjeje, por dua të theksoj se ky shkurtim i vogël në buxhet me 4,6%, pra 130 milionë lekë, nuk prek arritjen e objektivave të procesit të integritit europian.

Faleminderit!

**Senida Mesi** – Faleminderit, zoti Dedja!

Doja të bëja një sqarim të vogël dhe një analizë krahasuese. Ju sapo përmendët se ka një shkurtim prej 4,6% të buxhetit, që i bie diku në vlerën 1,3 milionë dollarë, 130 milionë lekë. Pra, vetëm për këtë shifër bëhet fjalë?

**Sokol Dedja** – Po, konfirmoj se bëhet fjalë për këtë shifër.

**Senida Mesi** – Fjalën e kanë kolegët deputetë nëse kanë pyetje, sugjerime apo rekomandime.

Më lejoni t'ju përmend që kemi të pranishëm zotin Gjoni, Pendavinji, zonjën Kumbaro dhe zonjën Hyseni.

Fjalën e ka zoti Gjoni.

**Ralf Gjoni**- Faleminderit!

Faleminderit, zonja nënkryetare!

Faleminderit, zoti Dedja, për prezantimin tuaj!

Unë deklaroj votën time kundër, si do që shkojë prezantimi dhe pyetjet e kolegëve, sepse nuk besoj që shkurtrimi i buxhetit i shkon përshtat nevojshmërisë së prioriteteve të politikës së jashtme dhe integritimit europian për Shqipërinë.

Kam një pyetje për zotin Dedja: gjatë fjalës suaj folët për vazhdimin e punës për sigurimin e vendit anëtar jo i përhershëm në Këshillin e Sigurimit. Çfarë është bërë deri sot në terma financiarë? Pra, çfarë harxhimesh keni bërë ju si ministri për këtë qëllim? A mendoni se mbështetja nga qeveria është e mjaftueshme për të arritur këtë qëllim madhor për politikën e jashtme shqiptare?

**Senida Mesi** - A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Zoti Dedja, fjala për ju.

**Sokol Dedja**- Faleminderit, zonja Mesi!

Faleminderit për pyetjen, zoti Gjoni!

Lidhur me vijimin e punës për sigurimin e mbështetjes së një vendi jo të përhershëm në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, puna jonë ka konsistuar në thellimin e kontakteve me vendet anëtare të OKB-së për të fituar mbështetjen e tyre. Kjo përfshin: vizitat lobuese, aktivitetet e zhvilluara nga misioni ynë në OKB. E përkthyer kjo në buxhet, më duhet t'ju kërkoj ndjesë që nuk i kam këto shifra tani, por marr përsipër t'jua përcjell menjëherë pas mbledhjes.

Faleminderit!

**Ralf Gjoni** - Pyetja e dytë imja është sa i përket vënies në dispozicion të fondeve nga qeveria për këtë propozim të buxhetit, a mendoni se mjafton për vitin e ardhshëm?

**Sokol Dedja** – Në situatën e vështirë ku jemi ne mirëkuptojmë nevojën për të shkurtrim të vogël në buxhet, i cili gjykojmë se nuk do të prekë cilësinë dhe suksesin e aktiviteteve tona për sigurimin e vendit jo të përhershëm në Këshillin e Sigurisë.

Faleminderit!

**Senida Mesi** – Zoti Dedja, ju falënderoj!

Sigurisht, kur flasim për buxhetin e vitit 2021 sfidat për qeverinë shqiptare janë të shumta dhe besoj se të gjithë jemi koshientë për prioritetet për Shqipërinë, siç është: rimëkëmbja pas situatës pandemike, që uroj ta kalojmë sa më shpejt, megjithëse duket se kemi para një vit të vështirë, për të ecur dhe avancuar edhe me axhendën e rindërtimit dhe më pas, që është shumë e

rëndësishme, me rritjen ekonomike. Sigurisht, shëndeti është i pari, ndoshta në vijim edhe të shpenzimeve të reduktuara edhe për hyrje-dalje, lëvizjet, të cilat ju i shihni edhe vetë fare mirë që shumica e takimeve po bëhen *online*, besoj dhe gjykoj që procesin e integritit nuk do ta penalizojë reduktimi prej 130 milionë lekësh, por dua të theksoj se edhe nga takimi që kemi pasur me përfaqësues të Ministrisë së Financave rreth 4,5 milionë euro kanë qenë të akorduara vetëm për pjesëmarrjen e Shqipërisë dhe drejtimin saj në Presidencën e radhës së OSBE-së. Pra, një shifër, që tashmë nuk është e domosdoshme sa kohë që kësaj presidence po i vjen fundi. Duhet të kuptojmë pak edhe sfidat ku ndodhemi dhe suksesi do të jetë nëse kemi përmirësime dhe lançohet sa më parë një vaksinë, nëse kemi sa më pak humbje njerëzish nëse sistemi shëndetësor nuk pëson asnjë kolaps dhe vazhdon ta menaxhojë situatën me një rritëm të tillë, kaq pozitiv, sikurse e kemi menaxhuar deri tani. Sfida jonë ishte dhe është rritja e rrogave të mjekëve, infermierëve dhe mësuesve, pasi, siç e dimë, ato janë në linjën e parë, por nuk mund të imagjinojmë një zhvillim të një vendi nëse nuk kemi dy prioritete: nëse nuk kemi njerëz të shëndetshëm dhe nëse nuk kemi brez te ri të miredukuar, pavarësisht sfidave dhe vështirësive të cilat hasim. Edhe për të ardhurat e vitit të ardhshëm, ne jemi përsëri këtu prezent dhe me kërkesën e ministrisë, por të adresuar edhe Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, për të ndryshuar dhe amenduar pozitivisht buxhetin e vitit që vjen, nëse situata paraqitet e favorshme. Sigurisht, nëse flasim vetëm për buxhetin, të cilin e shohim si zë, të paraqitur edhe nga ministria e linjës vetëm për pjesën e financimit ose mbulimit të shpenzimeve për integrimin në BE, unë jam me mendimin e zotit Gjoni, që e tha herën tjetër, që ne duhet të jemi aty të pranishëm dhe me buxhete të mjaftueshme edhe për përfaqësimin e Shqipërisë në sistemin e diplomacisë, kur jo pak herë ka pasur vështirësi për përfaqësimin në krahasim me vendet e tjera. Kur flasim për buxhete, flasim për limitime, po të ishte që nuk flasim për buxhete dhe do të kishim luksin të harxhonim sa më shumë, besoj se nuk do të bënim dëgjesa dhe nuk do të kishim asnjë problem, por thjesht do të ishim në versionin të gjejmë ku t'i çojmë paratë.

E rëndësishme dhe sfidë është të fusim në arkën e shtetit pikërisht ato të ardhura, të cilat janë të parashikuara, me qëllim që të përballojmë sfidat që sapo përmendëm.

Me kërkesë të anëtarëve të këtij komisioni, zoti Dedja, unë do të doja që nga departamenti juaj i financës dhe me ndihmën edhe të sekretarit të Përgjithshëm të na bëni një analizë krahasuese në 3-4 vjetshin e fundit, si ka ecur buxheti, me zëra të përcaktuara, me qëllim që të shohim që realisht ne kemi buxhete të mjaftueshme dhe disa zëra të veçantë, të cilët nuk janë tashmë të

domosdoshme sikurse ishte buxheti për pjesëmarrjen e Shqipërisë në Presidencën e radhës së OSBE-së, pra nuk do të jetë më i nevojshëm. Pra, të kemi një analizë krahasuese, për të kuptuar mirë që reduktimet vijnë në ato zëra, që ju mendoni se nuk do të cenojnë procesin e integritit, pasi flasim jo vetëm për një objektiv kryesor të Shqipërisë në politiken e jashtme, por po flasim dhe për një dëshirë madhore të të gjithë shqiptarëve për të qenë sa më pranë BE-së.

Nëse nuk keni asnjë pyetje ose diskutim tjetër, do të doja t'u kërkoja anëtarëve të komisionit të kalojmë në miratimin nen për nen.

Zoti Sterojvski, keni pyetje?

Po, fjala për ju.

**Vasil Sterjovski** – Faleminderit!

Në planin kombëtar të qeverisë së Republikës së Shqipërisë për zbatimin Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me BE-në 2012-2015 është përfshirë negociimi i marrëveshjeve ndërshtetërore me vendet e rajonit për mbrojtjen e minoriteteve. Çfarë është bërë me këtë angazhim të Republikës së Shqipërisë? A është bërë ndonjë kontakt nga ana e ministrisë suaj me shtetet fqinje për realizimin e këtij angazhimi të qeverisë shqiptare?

**Sokol Dedja** – Faleminderit!

Forcimi i mbrojtjes së të drejtave të pakicave kombëtare mbetet një objektiv që ka angazhimin tonë maksimal, përfshirë edhe kontaktet me vendet fqinje, mike dhe partnere. Siç e dini, Shqipëria ka miratuar ligjin kuadër “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”, dhe është duke finalizuar plotësimin e tij me akte nënligjore.

Faleminderit!

**Senida Mesi** – Në fakt, zoti Dedja nuk e përmendi, por ky është një kusht në linjë edhe me pjesën e negociimit të të gjithë strukturës negociuese pas Konferencës së Parë Ndërqeveritare. Kuvendi, me rezolutën e fundit që ka aprovuar në lidhje me planin e masave, ka përcaktuar daljen e akteve nënligjore në lidhje me dy ligje shumë të rëndësishme, atë të pronësisë dhe atë ligjin e pakicave, të cilat prekin edhe një çështje të tillë në lidhje me integrimin. Janë akte nënligjore që Këshilli i Ministrave dhe agjencitë përkatëse duhet t'i përfundojnë pjesën më të madhe brenda dhjetorit të këtij viti dhe pjesa që mbetet, e kemi përcaktuar në planin e masave, maksimumi deri në mars të vitit që vjen.

Unë nuk shoh asnjë dorë të ngritur për pyetje ose komente.

Kalojmë në votimin nen për nen.



Përderisa nuk kemi asnjë ndryshim, unë mendoj t'i kalojmë të gjitha nenet në lidhje me projektpropozimin për buxhetin e vitit 2021.

Kush është dakord? Kundër? Zoti Gjoni, zoti Çaçani.

Abstenim? Zonja Hyseni. Zoti Pendavinji jeni dakord?

Zoti Balla dhe zoti Velaj, a mund të shprehni votën tuaj, ju lutem?

Ju faleminderit!

Kemi shumicën që aprovon projektligjin “Për buxhetin e vitit 2021”. Kështu që ia përcjellim komisionit përgjegjës raportin e komisionit tonë për këtë projektligj.

Faleminderit!